

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **612-23-12493-5-5-8**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me pajisje të teknologjisë informative**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>" INFINITT " SH.P.K.</b>
NUI	<b>601614177</b>
Adresa	<b>Dëshmorët e Kombit</b>
Vendi	<b>PRISHTINË</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>044/974-590</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Astrit Uka</b>
Adresa elektronike	<b>infinitt.shpk@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>22.12.2023</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Furnizim me pajisje të teknologjisë informative**

**Njoftimi për kontratë: 10.11.2023.**

**Afati i fundit për dorëzimin e ofertav: 22.11.2023.**

**Data dhe ora e hapjes se ofertav: 22.11.2023. ora 13:30**

**Njoftimi mbi vendimin e AK: 06.12.2023.**

**Kriter për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëturjeshe në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Kërkesë për ri-shqyrtim kemi parashtruar me 11.12.2023.**

**Vendimin për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim kemi pranuar me 14.12.2023.**

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e*

*Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1- Qellimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 27- Dosja e Tenderit

Neni 52.3- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 56.3- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59.4- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 44.2 dhe 44.3 RrPP- Formularët Standard

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 24.11. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letrat standarde per OE ofertues ku eshte rekomanduar per kontrate oferta e kompanise sone si tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet per kete aktivitet te prokurimit.

Pas dorezimit te kerkeses per ri-shqyrtim nga OE Botek shpk zyra e prokurimit ka kthyer lenden ne ri-vleresim dhe me 06.12. ka rekomanduar per kontrate OE ankues Botek shpk. Oferta e te cilit ishte e treta me cmimin me te ulet per kete aktivitet te prokurimit Konstatimi i AK/komisionit vleresues per eliminimin e ofertes sone eshte jo-ligjor dhe i pa drejte.

AK/ KK Fushe Kosove pasiqe ka aprovuar pretendimet ankimore te OE Botek shpk ka eliminuar oferten e kompanise sone bazuar ne vendimin e OSHP-se nr. 214/22 me arsyetimin se nuk kemi dorezuar broshurat e produkteve dhe nuk kemi cekur brendin e ofruar.

Ky konstatim i AK/komisionit vleresues nuk qendron, ne ftesen per oferte te perpiluar nga AK/ KK Fushe Kosove tek pika IV.6 eshte kerkuar te dorezohen dokumentet si ne vijim: IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe **Lista e**

### **Dokumente të kërkuara**

Tenderi do të përbëhet nga dokumentet e plotësuar dhe të nënshkruara si në vijim:

- a. Formulari i Dorëzimit të Tenderit që gjendet në Pjesën B të FPO-së;
- b. Deklarata mbi Specifikimet Teknike të objektit të ofruar të kontratës, që korrespondon me ato të përmendura në Aneksin 1 të FPO-së.
- c. Siguria e Tenderit, nëse zbatohet; dhe
- d. [specifiko ndonjë Dokumente tjera të nevojshme].

Tri kërkesat e lartecaktuara kompania jone ka dorëzuar/plotesuar, tek pika d autoriteti kontraktues nuk ka specifikuar/kerkuar ndonje dokument shtese.

Poashtu ne nenin VI.2) te FPO-se/ **VLERËSIMI I TENDERIT** eshte cekur

Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të kërkesave të parashtruara në këtë FPO. Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur është në përputhje me të gjitha kërkesat e kësaj FPO.

Bazuar ne dispozitat ligjore te ligjit per prokurim publik ne fuqi, neni 52.3/ 56.3 dhe 59.4 AK i ndalohet qe gjate vleresimit te ofertav te perdore kritere jo te matshme te cilat me pare nuk jane specifikuar/ percaktuar ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne kete rast ne Ftese per ofertim.

Citoj nenin 52.3 te LPP-se

Neni 52

Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

**3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim.** Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike.

Citoj nenin 56.3 te LPP-se

Neni 56

Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

**3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

Citoj nenin 59.4 te LPP-se

**4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit**

AK ne vendim i referohet vendimit te OSHP-se nr. 214/22 i cili eshte nxjere me 20.06.2022. dhe nuk mund te paralelizohet dhe krahasohet me kete kontrate e cila eshte nenshkruar ne AQP me 30.10.2023. dhe ka terme te ndryshme nga kontrata e cila ka qene ne fuqi deri me 30.08.2023. ne baze te ciles eshte nxjere dhe ka qene baze per shqrtim lenda nr. 214/22.

Kushtet e kontrates e cila ka qene ne fuqi kur eshte nxjere vendimi i lartecekur kane qene te ndryshme nga kontrata aktuale e cila eshte ne fuqi.

Bazuar dhe ne termet e kontrates, citoj nenin 4.3 ne faqe 3 te kontrates:

Sa here qe shfaqet nevoja per furnizim, autoriteti kontraktues pergadite ftesen per kuotim (FPK) dhe do te leshoje FPK per te gjitha palet e kontrates publike kornize. **Vleresimi i kontrates ndihmese do te bazohet ne kriteret e theksuara ne FPK.**

Në një situatë të tillë AK duke mos specifikuar në FPO se dokumenti i specifikimeve teknike duhet të dorezohet dhe të përfshijë edhe informatat për modelet dhe specifikimet e pajisjeve të ofertuara si dhe katalogun, si informata të cilat kërkohen nga kushtet e marrëveshjes bazë, ka lënë mundësinë që OE-të të ofertojnë pa dhënë informacion se me cilat produkte ofertojnë. Kompania jone është kualifikuar në AQP me brendin HP dhe broshurat të cilat kemi dorezuar në ofertim me 28.08.2023. Kompania jone në ofertim tek AK KK Fushe Kosove nuk e ka parë të nevojshme të ngarkojë edhe njëherë broshurat të cilat kemi dorezuar në ofertim në AQP. AK në përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim ka cëkur kërkesat e ANEKS 1 të dosjes së tenderit të përpiluar nga AQP në bazë të ciles kemi ofertuar, këto kërkesa kanë qenë në dosjen e përgaditur nga AQP dhe në bazë të ciles jemi kualifikuar më përpara nuk janë kërkesa të parashtruara nga KK Fushe Kosove në Ftesën për ofertim në këtë mënyrë nuk mund të përdoren as në këtë fazë për vlerësim. AK/ KK Fushe Kosove në konstatimet e nxjerra dhe arsyen për eliminim ndaj kompanisë sone në njoftimin mbi vendim i referohet vendimit të OSHP-së nr. 214/22 vendim i cili nuk mund të paralelizohet me këtë projekt. Vendim me të ri i vitit aktual është vendimi me nr protokoli 356, 373, 389/23 të cilin po e bashkangjesim me ankese poashtu interpretimin e KRPP-së të leshuar me datë 16.03.2023. në bazë të cilit dhe duke ju referuar nenit 44.3 të RrPP operatorëve ekonomik ofertues nuk u lejohej nderhyrja në përshkrimin e cmimeve apo dokumentet tjera të dosjes në përjashtim të vendosjes së logos në dokumente apo shënim të kompanisë, Rrjedhimisht paramasa/përshkrimi i cmimeve ngarkuar në sistem nga KK Fushe Kosove nuk ka hapësirë ku do të duhej të çekoj brendin apo modelin e pajisjeve prandaj çdo nderhyrje eventuale e jona tek përshkrimi i cmimeve do të bënte ofertën të papërgjegjshme. AK përkundrazi që nuk e ka specifikuar në Ftesën për oferte këtë kërkesë ka mundur që gjatë fazës së vlerësimit të ofertave të kërkojë sqarime shtesë nga zyra e prokurimit nga AQP apo nga kompania jone modelet e produkteve me të cilat në jemi kualifikuar dhe do të implementonim projektin në fjalë. Bazë ligjore për këtë po e marrim vendimin e OSHP-së nr. 121/23 të cilin po e bashkangjesim me ankese. Marrëveshja kornizë lidhur me AQP-në dhe mini tenderët duhet të përmbahen nën 54.40 të rregullores për prokurim publik me nr. 001/2022 Zhvillimi i procedurës (mini tenderimi) në rastet e aktiviteteve të prokurimit qendror të zhvilluar nga ana e Agjencisë Qendror të Prokurimit në emër të Autoriteteve të tjera kontraktuese duhet të zhvillohet nga

vetë Autoriteti kontraktuese kurdo që lind nevoja.  
Ndërsa neni 54.41 parasheh që Mini-tenderimi duhet të jetë në bazë të kushteve të njëjta dhe nëse është e nevojshme sipas termeve të formulara si dhe kurdo që është e përshtatshme termave të tjera të cilave ju referohet specifikimi në kontratën publike kornizë. Kjo i nënshtrohet ndalimit (shmangie ose kufizime esenciale) prej termave të përcaktuar në kontratën publike kornizë.  
Bazuar në faktet e lartecitura konstatohet se AK/ KK Fushe Kosove nuk ka bërë vlerësim të drejte të ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe kompania e cila është eliminuar pa të drejtë megjithatë kemi qenë oferta e përgjegjshme me cmimin me të ulët për këtë aktivitet të prokurimit.  
Prandaj kërkojmë nga Organi Shqyrtues i prokurimit që pas shqyrtimit të provave dhe fakteve të aprovojë ankesën e kompanisë së cilës është bazuar dhe të kthehet lenda në ri-vlerësim, vlerësimi i ofertave nga KK Fushe Kosove të bëhet bazuar në kriteret/kërkesat e parashtruara në ftesën për ofertim.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Si pasoje e shkeljeve të lartecitura nga AK/komisioni vlerësues ka ardhur deri të dhenia e kontratës për OE me të shtrejtë, në këtë mënyrë nuk është respektuar neni 60 i LPP-se që kontrata të ipet tenderuesit të përgjegjshëm me cmimin me të ulët, poashtu kompanisë së cilës është mohuar fitimi i paramenduar nga kjo kontratë gjë që na shkakton humbjen e fitimit të pritur si dhe demtimin e buxhetit perkatesisht KK Fushe Kosove për 1052.50euro.**

**Kërkojmë Organi shqyrtues i prokurimit që të aprovojë ankesën e kompanisë së cilës është bazuar dhe lenda të kthehet në ri-vlerësim.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkëngjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit."*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*